



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 76/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “DWH-Kosova” sh.p.k. - Prishtinë, kundër njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me instrumente gjeodezike për monitorimin dhe kontrollimin e objekteve ndërtimore”, me nr. të prok: AP-616/18/106/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - /Komuna Prishtinë/ më datën 21.03.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET**, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “DWH-Kosova” sh.p.k. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me instrumente gjeodezike për monitorimin dhe kontrollimin e objekteve ndërtimore”, me nr. të prok: AP-616/18/106/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. **VËRTETOHET** njoftimi për kontratë i AK -së /Komuna Prishtinë/, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Furnizim me instrumente gjeodezike për monitorimin dhe kontrollimin e objekteve ndërtimore”, me nr. të prok: AP-616/18/106/121 dhe obligohet autoriteti kontraktues që të bëjë zgjatjen e afatit për ofertim, sipas dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “DWH-Kosova” sh.p.k. - Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:24.01.2018.

Hapja e ofertave është paraparë me dt:16.02.2018, sipas njoftimit për kontratë.

Pa informatave shtesë ose përmirësimi i gabimit në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është data e fundit e dorëzimit të ofertave dhe hapja e ofertave është parashikuar të bëhet me dt:13.03.2018

Kundër njoftimi për kontratë, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik: “DËH-Kosova” sh.p.k. - Prishtinë, me dt:23.02.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 26.02.2018, autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim e operatorit ekonomik: “DWH-Kosova” sh.p.k. – Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues: “DWH-Kosova” sh.p.k. - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 27 Shkurt 2018, me nr. 76/18, kundër njoftimit për kontratë me titull: “Furnizim me instrumente gjeodezike për monitorimin dhe kontrollimin e objekteve ndërtimore”, me nr. të prok: AP-616/18/106/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:

- Shkelje të nenit 1, 7, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.03.2018, ka autorizuar ekspertët shqyrtuese, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertët Shqyrtues, në raportin e dt: 14.03.2018, kanë sqaruar pretendimet e OE ankues: Lidhur me pretendimin e OE ankues, se specifikimet teknike janë bërë për të përjashtuar mbi 99% të produkteve që ofron tregu. Eksperti teknik-shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor sepse ekzistojnë instrumente të firmave të ndryshme që i plotësojnë specifikimet teknike, siç janë Leica GS18-T , Topcon Hiper-HR , Stonex S800, Trimble R10 etj.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, te specifikimet teknike indirekte - ku kërkohen 400 kanale për GPS e ndërkohë numri kanaleve nuk është tregues direkt, por indirekt, dhe se 98% e prodhuesve prodhojnë GPS 220 kanale, të cilët janë përjashtuar nga AK pa shkak të vërtetuar cilësor dhe performancë. Eksperti teknik-shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor sepse teknologjia gjithnjë e më shumë po avanson dhe me të edhe prodhues e ndryshëm sjellin produkte më të avancuara të cilat kanë edhe GPS me mbi 400 kanale siç janë prodhuesit: Leica GS18-T , Topcon Hiper-HR , Stonex S800, Trimble R10 etj.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, te specifikimet teknike të paplota – ku thotë se kërkohet që GPS të jetë me matje të pjerrët deri ne 10 shkallë. Eksperti teknik-shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor sepse në specifikimet teknike ne dosjen e tenderit shkruan: “korrigjimet e shmangies së gabimeve të qendërsimit të ketë jo më pakëz se 10 shkallë”, pra ka kërkuar 10 shkallë e më shumë e jo si thotë OE deri ne 10 shkallë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, te specifikimet teknike deviatore – për terminologjinë Tastaturë. Eksperti teknik-shqyrtues vlerëson se mund të qëndrojë pretendimi ankimor sepse në specifikimet teknike Autoriteti Kontraktues ka mundur në vend të fjalës tastaturë të përdor kontrolleri, por pasi e ka përdorur edhe fjalën terminali atëherë ka qenë e kuptueshme për operatorët ekonomik.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, kërkesa pa bazë aritmetikore – për mesataren e kanaleve. Eksperti teknik-shqyrtues vlerëson se kjo ankesë lidhet me përgjigjen e parë ku nuk është e rëndësishme mesatarja e kanaleve përderisa ekzistojnë instrumente që kanë mbi 400 kanale.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, kërkesa paushall të padefinuara dhe të papërfshira në kontratën e tenderit – në kërkesat juridike kërkohet 3 vjet garanci nga prodhuesi ku përfshihet mirëmbajtja, kalibrimi dhe servisimi. Eksperti teknik-shqyrtues vlerëson se është e drejtë e AK-së të kërkojë periudhën e garancionet pasi që çdo pajisje e re bartë edhe periudhën e garancion për produktin të cilën e kërkon kurse

për mirëmbajtje, kalibrim dhe servisim është sqaruar AK, në përgjigjen e kërkesës për ri-shqyrtim ku thekson me të drejtë se mirëmbajtja përfshin update të versioneve të ri softuerike, si dhe kalibrimi pasi që nuk mundet të punoj paisja pa të.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik-shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzoj si të pa-bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet e lartë cekura), njëherit rekomandoj që ky aktivitet i prokurimit të vazhdoj më tutje.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Prishtinë, me datë: 14.02.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “DËH-Kosova” sh.p.k. - Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 16.03.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 21.03.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, eksperti teknik i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK znj.Isufi deklaroj: Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe njëherit mbështesim raportin e ekspertizës së ekspertit teknik i propozojmë panelit të lejoj AK të vazhdoj me procedura të mëtutjeshme.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Hoxha deklaroj: Të gjitha konstatimet dhe përgjigjet në pikat ankimore i gjeni në raportin e datës 14.03.2018. Qëndroj ranë raportit dhe konstatimeve e rekomandimeve të dhëna në raport.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE ankues, se specifikimet teknike janë bërë për të përjashtuar mbi 99% të produkteve që ofron tregu, sikurse e kanë cekur edhe ekspertët e OSHP-së, vlerëson se nuk qëndron pretendimi

ankimor sepse ekzistojnë instrumente të firmave të ndryshme që i plotësojnë specifikimet teknike, siç janë Leica GS18-T , Topcon Hiper-HR , Stonex S800, Trimble R10 etj.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, te specifikimet teknike indirekte - ku kërkohen 400 kanale për GPS e ndërkohë numri kanaleve nuk është tregues direkt, por indirekt, dhe se 98% e prodhuesve prodhojnë GPS 220 kanale, të cilët janë përjashtuar nga AK pa shkak të vërtetuar cilësor dhe performancë, paneli shqyrtues ashtu siç e kanë cekur edhe ekspertët e OSHP-së vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor sepse teknologjia gjithnjë e më shumë po avanson dhe me të edhe prodhues e ndryshëm sjellin produkte më të avancuara të cilat kanë edhe GPS me mbi 400 kanale siç janë prodhuesit: Leica GS18-T , Topcon Hiper-HR , Stonex S800, Trimble R10 etj.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, te specifikimet teknike të paplota – ku thotë se kërkohet që GPS të jetë me matje të pjerrët deri në 10 shkallë, paneli shqyrtues ashtu siç e kanë cekur edhe ekspertët e OSHP-së, vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor sepse në specifikimet teknike në dosjen e tenderit shkruan: “korrigjimet e shmangies së gabimeve të qendërsimit të ketë jo më pakëz se 10 shkallë”, pra ka kërkuar 10 shkallë e më shumë e jo si thotë OE deri në 10 shkallë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, te specifikimet teknike deviatore – për terminologjinë Tastaturë, paneli shqyrtues ashtu siç e kanë cekur edhe ekspertët e OSHP-së, vlerëson se mund të qëndrojë pretendimi ankimor sepse në specifikimet teknike Autoriteti Kontraktues ka mundur në vend të fjalës tastaturë të përdor kontrolleri, por pasi e ka përdorur edhe fjalën terminali atëherë ka qenë e kuptueshme për operatorët ekonomik.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, kërkesa pa bazë aritmetikore – për mesataren e kanaleve. paneli shqyrtues ashtu siç e kanë cekur edhe ekspertët e OSHP-së, vlerëson se kjo ankesë lidhet me përgjigjen e parë ku nuk është e rëndësishme mesatarja e kanaleve përderisa ekzistojnë instrumente që kanë mbi 400 kanale.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, kërkesa paushall të padefinuara dhe të papërfshira në kontratën e tenderit – në kërkesat juridike kërkohet 3 vjet garanci nga prodhuesi ku përfshihet mirëmbajtja, kalibrimi dhe servisimi, paneli shqyrtues ashtu siç e kanë cekur edhe ekspertët e OSHP-së, vlerëson se është e drejtë e AK-së të kërkojë periudhën e garancionet pasi që çdo pajisje e re bartë edhe periudhën e garancion për produktin të cilën e kërkon kurse për mirëmbajtje, kalibrim dhe servisim është sqaruar AK, në përgjigjen

e kërkesës për ri-shqyrtim ku thekson me të drejtë se mirëmbajtja përfshin update të versioneve të ri softuerike, si dhe kalibrimi pasi që nuk mundet të punoj pajisja pa të.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Prishtinë/

1x1 OE - "DWH-Kosova" sh.p.k. - Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.